



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**  
**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 2006 / Prot. 3

Tiranë, më 27.11.2024

**Lënda:** Kërkesë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të datës **09.12.2024**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

**Tiranë**

Në zbatim të Kreut II pika 13 e VKM nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” i ndryshuar, dhe Lidhjes 1, Shtojca 1 e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 269 datë 11.08.2020 i ndryshuar, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim “FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK”.

Njoftimi ju dërgohet edhe në format elektronik (CD) si dhe në adresën zyrtare të emailit – [info@app.gov.al](mailto:info@app.gov.al).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**SOKOL ISMAILI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Tiranë** njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **“RESTAURIMI I KISHËS FJETJA E SHËN MËRISË, FSHATI BISHQETHËM, LUSHNJE”**, Monument Kulture i kategorisë së I-rë.
3. Llojin e punës: **“RESTAURIMI I KISHËS FJETJA E SHËN MËRISË, FSHATI BISHQETHËM, LUSHNJE”**
4. Fondi limit i procedurës së konkurrimit **8.718.378** (*tetë milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë*) **lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës \_\_\_\_\_ ditë, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **jo më pak se 8 ditë nga publikimi** i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **17.12.2024 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimit publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: [www.iktk.gov.al](http://www.iktk.gov.al) në Rubrikën “Rreth nesh/Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë **17.12.2024 ora 10:00** në Autoritetin Kontraktor/Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, kati II, salla e Bibliotekës, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej **7- ditësh** nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.